

## PROJEKTI “NJËQIND DRITA PËR TË GJITHË”

Lulishta “Vaso Kadija”

Aktualisht Bashkia Shkodër administron një sipërfaqe prej 72 600 m<sup>2</sup> hapsirash të gjelbra, lulishte, parqe dhe zona rekreative, ku përfshihen 54 lulishte. Duke marrë parasysh përdorimin e këtyre hapsirave dhe funksionalitetin që ato kanë për komunitetin është e nevojshme të kemi një vëmendje të veçantë në trajtimin e këtyre hapsirave. Lulishta “Vaso Kadija” mund të thuhet që është e mirëmbajtur, me pemë dekorative dhe gjelbërim, por ka të nevojshme integrimin e elementeve të ndryshme të dekorit urban në shërbim të frekuentuesve për ta bërë atë edhe më atraktive. Kjo lulishte pavarësisht gjelbërimit nuk ka kushte për fëmijet dhe moshat e treta, të cilët preferojnë qëndrimin në mjedis të hapura, me hapsira të dedikuara ku mund të luajnë apo kalojnë kohën e lirë. Ky projekt financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), përmes Programit për Zhvillimin Rajonal Shqiperi. Qyteti i Shkodrës, për vetë pozitën gjeografike, por edhe historikut të zhvillimit të saj përbri liqenit të Shkodrës dhe e rrethuar nga lumenjtë, ka shumë hapsira të gjelbra e rekreative, ku komuniteti mund të kalojë kohën e lirë. Shkodra është një qytet i mirë-strukturuar i gjelbër dhe i qetë me dendësi mesatare dhe me arkitekturë tradicionale, parqe të gjelbra dhe sipërfaqe të hapura. Bashkia Shkodër synon që edhe në qendrat e qytetit dhe njërive administrative të kenë hapsira rekreative me lojra, stola e të tjerë elementë të dekorit urban në shërbim të komunitetit.

Bashkia e Shkodrës është fuqimisht e angazhuar për ta kthyer qytetin e vet në një qytet të gjelbër, të jetueshëm, me dimensione njerëzore me synimin e zhvillimit të një qendre të madhe në veri të Shqipërisë, si Portë e Gjelbër me të gjitha karakteristikat e veta kulturore e tradicionale me facilitete të përshtatshme zhvillimi. Projekti “Njëqind drita për të gjithë” përmes rikualifikimit të lulishtes “Vaso Kadija” ka si objektiv rivitalizimin total të lulishtes dhe kthimin e saj në një nga qendrat kryesore të rekreacionit në qytet duke plotësuar kështu rrejtën e lulishtave dhe hapsirave të gjelbërta të Bashkisë Shkodër e sidomos të qytetit si zonë urbane.

Grupet e synuara nga ky projekt janë:

- ❖ Fëmijët - që e frekuentojnë për të luajtur këtë ambient janë në numër të shumtë nisur edhe nga densiteti i lartë i popullsisë përreth kësaj lulishteje.
- ❖ Studentët – Lulishta ndodhet në afërsi të Universitetit “Luigj Gurakuqi” dhe frekuentohet shpesh nga ato për të lexuar, bashkëbiseduar apo pushuar.
- ❖ Moshat e treta - janë frekuentues të rregullt të kësaj lulishteje duke e shfrytëzuar atë për t’u shpërndarë apo luajtur letra, shah e domino.
- ❖ Vizitorët e ndryshëm – duke marrë parasysh afërsinë me pedonalen dhe baret e restorantet përreth rikualifikimit i lulishtes do të krijojë një hapsirë atraktive në shërbim të tyre.
- ❖ Artistët e ndryshëm – krijimi i hapsirave për artistëve të Shkodrës për ushtrimin e arteve pamore do të ndikojë në rritjen e atraktivitetit të zonës për të gjitha kategoritë dhe grupmoshat e ndryshme që e frekuentojnë këtë lulishte.

Rezultati i pritshëm nga realizimi i projektit është përmirësimi i cilesisë së jetesës së komunitetit përmes rikualifikimit të 4700 m<sup>2</sup> sipërfaqe lulishte duke e plotësuar me element dekorativ, stola tavolina që do të ndikojnë në rritjen e numrit të frekuentuesve të lulishtes nga grupmoshat e ndryshme. Gjithashtu ndriçim LED do të rrisë sigurinë për shfrytëzimin e kësaj lulishteje në të gjitha oraret. Konstruksion për Street Art dhe vitalizimi që do të marre lulishta përmes aktiviteteve

të ndryshme social – kulturore do të ndikojnë në zhvillimin e zonës. Këto rezultate do të arrihen duke zhvilluar aktivitetet e mëposhtme:

**1. Rritje dhe përmirësim i sipërfaqeve të gjelbërta si hapsira rekreative me elementet e arredimit urban.**

Një nga aktivitetet që parashikon projekti është rritja dhe përmirësimi i sipërfaqeve të gjelbërta si hapsira rekreative me elementët e arredimit urban si stola, tavolina etj. Kjo ndërhyrje do të shërbejë për të përmirësuar funksionalitetin dhe dekorin urban të qendrës së qytetit. Krijimi i 4700 m<sup>2</sup> sipërfaqe të gjelbëruar hapsirash, paisur me element të dekorit si stola, tavolina e këndin e lojrave do të ndikojë në rritjen e numrit të frekuentuesve të kësaj lulishteje.

**2. Krijimi i hapsirave rekreative për grupmoshat e ndryshme, vizitorët dhe zona e dedikuar për artin pamor (vizatimi, grafika, piktura, skulptura).**

Aktivitet tjetër i projektit do të jetë gjithashtu krijimi i hapsirave rekreative për grupmoshat e ndryshme, vizitorët dhe zona dedikuar për artin pamor (Vizatimi, grafika, piktura, skulptura), duke nxitur rritjen e numrit të frekuentuesve të kësaj lulishteje. Lulishta do të paiset me stola dhe tavolina për qëndrim dhe aktivitete rekreative të moshave të treta si dhe komunitetit përreth lulishtes. Hapsirat e dedikuara për lojrat e grupmoshave të ndryshme do të krijojnë mundësinë që fëmijët të kenë hapsirën e tyre ku të luajnë të sigurtë. Gjithashtu moshat e treta do të kenë stola dhe tavolina ku do të mund të kalojnë kohën e tyre të lirë. Si zonë e frekuentuar nga shumë studentë të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, përmirësimi i lulishtes do të ndikojë në rritjen e numrit të frekuentuesve të saj studentë, të cilët do të mund të lexojnë apo kalojnë kohën e lirë në një hapsirë të rikualifikuar. Krijimi i hapsirës së dedikuar për artistët është një tjetër element që do të ndikojë në rritjen e numrit të frekuentuesve, përmes zhvillimit të aktiviteteve sociale e kulturore të cilat do t’u bëjnë më atraktive për të gjithë këtë lulishte, sidomos për vizitorët e shumë që vizitojnë pedonalen dhe qendrën e qytetit, pranë lulishtes duke ndikuar kështu edhe në zhvillimin e kësaj zone.

**3. Rikonceptimi i ndriçimit të lulishtes me efekte dekori.**

Rikonceptimi i ndriçimit përmes vendosjes së 100 ndriçuesve LED me rreze drejt pemëve dhe 9 ndriçuesve të lartë LED, do të rimodelojnë ndriçimin e lulishtes duke e bërë atë shumë atraktive. Ky aktivitet do të ndikojë gjithashtu në rritjen e sigurisë dhe plotësimin të standardeve optimale për shfrytëzimin e kësaj lulishteje në të gjitha oraret. Përmirësimi i ndriçimit do të ndikojë direkt në zhvillimin e zonës dhe rritjen e numrit të frekuentuesve në çdo orar duke ofruar përveç efekteve dekorative edhe siguri të shtuar për frekuentuesit.

**4. Vizibiliteti i projektit.**

Me përfundimin e punimeve do të zhvillohet inaugurimi i projektit i cili do të ketë nevojë për vizibilitetin e punimeve të realizuara dhe promovimin e frekuentimit të kësaj lulishteje nga të gjithë. Ky aktivitet do të përfshijë realizimin e një klipi promovues për punimet e zhvilluara si dhe vizibilitetin përmes inaugurimit të lulishtes me një aktivitet festiv, me materiale promocionale, postera, bannerat etj.

**5. Mobilim i lulishtes me kende lojrash.**

Rikonceptimi i lulishtes si një hapsirë e perbashket komunitare do të plotësohet me tej përmes vendosjes së 4 modeleve të ndryshme të lojrave për fëmijë duke nxitur kështu frekuentimin e kësaj lulishteje nga ana e fëmijëve dhe prindërve të tyre. Krijimi i kendeve të lojrave dhe plotësimi i tyre me modele lojrash do të bëjë që lulishtja të jetë një pikë atraktive për të gjithë qytetin duke i dhënë një pamje tjetër kësaj zone.

Projekti do të zbatohet brenda periudhës kohore të pesë muajve nga lidhja e kontratës së Grantit me RDPA, sipas planit të prokurimit dhe planit të zbatimit të punimeve.



BASHKIA SHKODËR



MIRATOHET KRYETARI


VOLTANA ADEMI

# PROJEKTI "100 DRITA PER TE GJITHE" LULISHTA VASO KADIA




REPUBLICA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR


PLANIMETRI E NDRICIMIT  
Ne kuotën +1.00m



SASIA E NDRICIMIT  
NGA ANA VERI-LINDORE



SASIA E NDRICIMIT  
NGA ANA JUG-PERENDIMORE



Projekti financohet nga:





